

Mail federazione.fnai@gmail.com

PEC federazionefnai@pec.it

Facebook: FNAI - Federazione Nazionale delle Associazioni Albanesi in Italia IBAN

IT05S0501801600000016677916 C.F 91378810377

Sito <https://federazionefnai.org/> Sede Via Aldo Moro Nr 13 Cap 63900 Fermo (FM)

KOMUNIKATË!

Federata Kombëtare e Shoqatave Shqiptare në Itali (FNAI) njofton se me dt.10.10.2021, u zhvillua Asambleja zgjedhore e programuar në të cilën morën pjesë delegatë të shoqatave, si edhe aktivistë pa të drejtë vote. Asambleja mori në shqyrtim: a) Analizë e periudhës midis dy zgjedhjeve; b) Miratimi Programit për vitin 2021-2022; c) Zgjedhjet e reja.

Nje kopje e programit te aprovuar nga Asambleja ndodhet e publikuar ne faqen web te FNAI-it ne <https://federazionefnai.org>

Raportin e analizës vjetore për veprimtarinë e FNAI-it e mbajti dr.Margita Hoxha në të cilin, ndër të tjera u përmenden këto arritje.

1. Konferenca sensibilizuese e realizuar me avokatë, sindikalistë e specialistë në fushën e të drejtave të emigracionit për bashkimin e kontributeve të pensionit për emigrantët shqiptarë dhe anasjelltas, për shtetasit Italianë që punojnë në Shqipëri.

2. Realizimi në Tiranë i konferencës një ditore “Diaspora Faktor Uniteti dhe Qëndrese” në bashkëpunim me organizatën mbarë shqiptare në Europë LEASH, dhe fondacionin “Akademia Alternative Rrënjët Shqiptare”

3. Realizimi i një takimi online për organizimin e shpërndarjes së teksteve shkollore në përputhje me gjëndjen aktuale të shkollave shqipe nën juridiksionin e Federatës. Takimi ishte në bashkëpunim me oficeren për diasporën në Itali dr.Luljeta Cobanaj pranë Konsullatës së Përgjithëshme të Rep.së Shqipërisë në Itali(M.I) Delegatë e aktivistë të shoqatave përfaqësuese, analizuan dhe vlerësuan punën e deritanishme si edhe gjëndjen e rënduar nga pandemia Covid në disa shoqata të cilat nuk kanë arritur të riorganizohen për zbatimin e programeve të planifikuara, përfshirë edhe vështirësitë që po hasen nga mungesa e frekuentimit të nxënësve në shkollat dhe kurset e gjuhës shqipe.

Ndër të tjera në raport u përcaktuan si pika të ndikuara nga pandemia Covid për tu përmirësuar:

a. Angazhimi në projekte të përbashkëta.

b. Rendesia e sensibilizimi të prindërve për rritjen e frekuentimit të shkollave të gjuhës shqipe.

Raporti mbasi u plotësua me vërejtjet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve, mori formën e plotë dhe u miratua nga asambleja Në programin e vitit 2021-2022 në të cilin është parashikuar:

1- Realizimi i një konferencë sensibilizuese për gjuhën shqipe me pjesëmarrje të gjërë për trajtimin në rrugë shtetërore të mësim dhënies së gjuhës në institutet shkollore ku mësojnë fëmijët tanë.(Ratifikimi i ligjit 482/1999).

2- Ngritja e vetëdijes për një sensibilizim të gjithanshëm të dhunës ndaj grave, do të jetë një tjetër element i rëndësishëm i angazhimit të Federatës me një takim me gra nga shoqata të ndryshme, si edhe specialistë të cilët do të trajtojnë qëndrimet dhe sjelljet që nxisin ose lejojnë dhunën ndaj gruas.

3- Mbyllja tradicionale e fund -vitit me një konferencë të përbashkët vlerësuese dhe darkë familjare.

Për zgjedhjen e kandidaturave për 9 persona në Këshillin Drejtues si edhe 5 persona në komisionin e Garanci-Kontrollit u morën në konsideratë gjendja arsimore, profesioni, gjinia, eksperiencia dhe mosha.

Komunikojmë se Asambleja zgjodhi presidentin dhe organet e Federatës si më poshtë:

Përbërja e Këshillit Drejtues	Përbërja e Komisionit të Kontrollit & Garancisë
Presidente Këshilltare dr. Margita Hoxha Zv/President Këshilltar z. Granit Muçaj Sekretare Këshilltare ing. Erida Çela Perlala Këshilltare dr. Adela Shehu Këshilltar z. Alfred Kaci Këshilltar z. Dashamir Kërtusha Këshilltar ing. Artan Shyti Këshilltar z. Sefer Kikija Këshilltare znj. Donika Suli Finaciere e atashuar dr. Anisa Karagjozi	Znj.Adiola Kotorri Ing. Elda Hoxha Z. Astrit Nurka Z. Dritan Ferhati Z. Durim Moli E-mail i komisionit per kompetencat e tij sipas statutit: commissione.garanzia.fnai@gmail.com

Federazione Nazionale delle Associazioni Albanesi in Italia

